



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:904309

Datë: 02.02.2024

Numri i dokumentit: 05280498

C.nr.1375/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoresh profesionale Shkurte Kadriu, në çështjen juridike kontestimore të paditësve L. Sh., N. Sh. dhe E. Sh., që të gjithë nga Gj., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Isa Salihu avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.-W. I. G.”, me seli në P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Bali Mahmuti avokat nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim dëmi, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor e publik, më datë 20.12.2023 mori, ndërsa më datë 16.01.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësve L. Sh., N. Sh. dhe E. Sh., që të gjithë nga Gj., me të cilën kanë kërkuar që të DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S.-W. I. G.”, me seli në P., që paditësve nga baza juridike e sigurimit të autopërgjegjësisë të ia paguaj dhe atë:

- në emër të mbulimit të shpenzimeve për ngritjen e përmendores shumë prej 2,050.00 euro,
-në emër të fitimit të humbur-rentës për të kaluarën dhe të ardhmen në formë të kapitalizuar si pasojë e aksidentit të datës 12.09.2011 në Gjilan, ku humbi jetën i ndjeri D. Sh., t’ua paguaj shumë prej 16,403.74 euro, me kamatë ligjore prej 4.2 % nga data e aksidentit të komunikacionit me datë 12.09.2011 e deri më 31.12.2022, ndërsa nga data 01.01.2013 me kamatë ligjore prej 8%, si e pabazuar.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësit L. Sh., N. Sh. dhe E. Sh., që të gjithë nga Gj., përmes të autorizuarit të tyre, më datë 23.07.2012, kanë paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.-W. I. Gr.”, me seli në P., me objekt kontesti kompensim dëmi material dhe jomaterial.

Lidhur me këtë çështje, fillimisht është vendosur në mënyrë meritore me Aktgjykimin C.nr.548/2012 të datës 19.09.2017, ndaj të cilit aktgjykim është paraqitur ankesë, ku Gjykata e

Apelit sipas ankesës me Aktvendimin AC.nr.706/2018 të datës 11.08.2021, e ka APROVUAR si të themeltë ankesën e të paditurës Kompania e Sigurimeve “.W. I. G.”, ashtu që e ka PRISHUR pjesërisht Atgjkimin vetëm për pikën e III-të, (për dëmin material për shkak të ngritjes së përmendores dhe për fitimin e humbur), dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje.

Në procedurën e tanishme të rigjykimit, gjykata ka mbajtur dhe zhvilluar shqyrtimin gjyqësor nga fillimi, duke mbajtur seancë përgatitore dhe seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes, për t'i shqyrtuar të gjitha çështjet që i ka ofruar gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin e saj.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse:

Përfaqësuesi i paditësve në seancën e datës 03.08.2022, ka deklaruar se e njofton gjykatën se e paditura Kompania e Sigurimeve “.S.-W. I. G.”, pjesën e pandryshuar të aktgjykimit e ka përmbushur në tërësi, po ashtu ka theksuar që për paditësen F. Sh. nuk kërkojmë që të vlerësohet fitimi i humbur pasi që e njëjta ka ndërruar jetë si dhe i njëjti ka kërkuar që të veprohet sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit konform dispozitave të LPK-së,

Paditësit L. Sh., N. Sh. dhe E. Sh., përmes përfaqësuesit të tyre me autorizim, në seancë përgatitore, shqyrtim kryesor dhe fjalë përfundimtare, kanë deklaruar se kërkojnë nga gjykata që për konstatimin saktësisht gjendjen faktike për dëmin material ta ftoj ekspertin e aktuaristikës që të llogarisë renten e arritur për pagesë si dhe renten për të ardhmen sipas kontributit të pjesëmarrësve në aksidentin e komunikacionit.

Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësve dhe të detyrojë të paditurën që nga baza juridike e sigurimit të autopërgjegjësisë t'ua paguaj dhe atë: në emër të mbulimit të shpenzimeve për ngritjen e përmendores shumë prej 2,050.00 euro, në emër të fitimit të humbur-rentës për të kaluarën dhe të ardhmen në formë të kapitalizuar si pasojë e aksidentit të datës 12.09.2011 në Gjilan, ku humbi jetën i ndjeri Dorian Shkodra, t'ua paguaj shumë prej 16,403.74 euro, e në shumë të përgjithshme prej 18,453.74 euro, me kamatë ligjore prej 4.2°% nga data e aksidentit të komunikacionit me datë 12.09.2011 e deri më 31.12.2012, ndërsa nga data 01.01.2013 me kamatë ligjore prej 8%.

Shpenzimet e procedurës, i ka kërkuar në mënyrë të specifikuar, edhe atë: 405.00 euro për përpilimin e padisë, për taksë gjyqësore në shumë prej 525.00 euro, për katër seanca gjyqësore për secilën me nga 540.00 euro, për ekspertiza shumë prej 750.00 euro, e gjithsej në shumë të përgjithshme prej 3,840.00 euro sipas aktgjykimit C.nr.548/2012, ndërsa shpenzimet e krijuara sipas lëndës C.nr.1375/2021 dhe atë: për pesë seanca gjyqësore me nga 416.00 euro, si dhe për ekspertizën e aktuaristikës e datës 20.12.2023 në shumë prej 150.00 euro, e gjithsej në shumë të përgjithshme prej 6,070.00 euro.

E paditura, gjatë shqyrtimeve gjyqësore, si dhe në shpjegimet përfundimtare, ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadinë e paditësve për faktin se i ndjeri D. Sh. në momentin e vdekjes aksidentale ka qenbl i mitur 17 vjeç, nxënës i shkollës së mesme, ku në momentin e aksidentit nuk ka qenë në marrëdhënie pune me kontratë, ku kontrata e prezantuar për punë para aksidentit ka qenë vetëm sezonale për 3 muaj edhe atë prej datës 28.04.2011 deri më

28.07.2011, ndërsa aksidenti ka ndodhur me datë 12.09.2011, nga kjo rezulton se në momentin e ndodhjes së aksidentit nuk ka qenë i punësuar, dhe nuk ka qenë person i aftë financiarisht për mbajtje financiare të prindërve të tij, ku edhe sipas nenit 294 të LMD-së, si dhe faktit se paditësit L. dhe N. Sh. janë relativisht të moshës se re dhe sipas deklarimit të ish të autorizuarit të tyre me datë 26.03.2014, deklaroi se të dy prindërit janë në marrëdhënie pune dhe nuk i plotësojnë kushtet për mbajtje të humbur. Po ashtu edhe sipas ekspertizës së aktuaristikës e cila në fund të ekspertizës shënon klauzolën se llogaritja e mbajtjes së humbur bëhet nën supozimin se të gjitha kushtet ligjore plotësohen dhe nën supozimin se i ndjeri ka mund të jetë mbajtës i vetëm i familjes, e po ashtu bazuar edhe në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Yll Koshi se rasti është me ndarje 50% :50%. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjendja faktike e vërtetuar:

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Kontrata e punës e lidhur në mes të “MC Communication”, Sh.P.K., me nr të biznesit 70571641, me seli në Prishtinë, si punëdhënëse dhe punëtorit-tani të ndjerit D. Sh., si punëmarrës; Ekspertiza e ekspertit të komunikacionit e datës 01.22.2011, e përpiluar nga inxhinieri i komunikacionit Besim Ibrahimimi dhe e përpiluar në procedurë penale; Raporti i aksidentit CR.3004-352-11, i datës 12.09.2011; Aktakuza PP.nr.226/2011, e datës 27.12.2011, përpiluar nga Prokuroria e Qarkut në Gjilan drejtuar Gjykatës së Qarkut në Gjilan; Polica e sigurimit me nr.05 109621, në emër të të siguarit Shkelzen Canaj; Kontrata numër 535, e lëshuar nga Ndërmarrja Shërbyese “Amar”, me seli në Gjilan; Kopja e letërnjoftimit në emër të M. H. dhe B. R.; Vërtetimi për vdekjen, lëshuar nga QKUK-Klinika e Anesteziologjisë dhe Mjekimit Intenziv në Prishtinë, në emër të të ndjerit D. Sh.; Fletëvdekja me numër amë 308/2011, lëshuar nga QKUK në Prishtinë- Klinika e Anesteziologjisë dhe Mjekimit Intenziv; Certifikata e lindjes në emër të Nazmije Hiseni, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan; Certifikata e lindjes në emër të Lu. Sh., e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan; Certifikata e lindjes në emër të E. Sh., e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan; Certifikata e vdekjes me nr. rendor 1459, e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme me datë 28.09.2011; Certifikata e lindjes në emër të të ndjerit D. Sh., me nr. rendor 2378, e lëshuar në Prishtinë, me datë 30.03.2011; Kërkesa për kompensim dëmi material dhe jomaterial, drejtuar të paditurës; Njoftimi nga e paditura për palën kërkuese i datës 01.06.2012; Njoftimi lidhur me ankesën e datës 13.07.2012; Deklarata e bashkësisë familjare, me numër rendor 03/23170/12, e lëshuar në Gjilan, me datë 02.03.2012; Vërtetimi me nr.protokolit 48/12, i datës 27.02.2012, lëshuar nga Gjimnazi “Zenel Hajdini”, në Gjilan; Raporti specialistik neurologjik, lëshuar nga Qendra Diagnostike Terapeutike “Denta Med”, në Gjilan; Raporti mjekësor lëshuar nga Ordinanca Specialistike Psikiatrike në Gjilan, me nr.558/14, i datës 22.04.2014; Aktgjykimi penal P.nr.707/13, i plotëfuqishëm me datë 31.12.2013; Ekspertiza psikiatrike e datës 01.04.2014, e përpiluar nga Dr.Valdete Alidema Serreqi-psikiatër; Ekspertiza e aksidentit të komunikacionit e përpiluar nga eksperti gjyqësor Yll Koshi, e datës 08.05.2012; Ekspertiza financiare e datës 10.09.2014, e përpiluar nga eksperti financiar gjyqësor Ali Gagica; Certifikata e lëshuar nga Zyra Komonale për Punësim në Gjilan, e datës 05.09.2014, në emër të L. Sh.; Certifikata tjetër e datës 05.09.2014 në emër të N. Sh.; Dëftesa e lëshuar nga Gjimnazi

“Zenel hajdini”, në Gjilan, me nr. të protokollit 94/12, në emër të të ndjerit D. Sh.; Të dhënat nga trusti i kursimeve pensionale; Kopja e librezës së qarkullimit në emër të Sh. C.; Pasqyra financiare e lëshuar nga raiffeisen bank, në emër të D. Sh.; Pasqyra e trustit të kursimeve pensionale në emër të të ndjerit D. Sh.; Pasqyra e trustit të kursimeve pensionale në emër të L. Sh.; Ekspertiza e komunikacionit e punuar nga grupi i ekspertëve Ing.dipl.Kimete gashi, S. Sh. dhe B. L., e pranuar në gjykatë me dfatë 20.05.2016; Superekspertiza nga lëmi i aktuaristikës e përpiluar me datë 14.06.2017; Ekspertiza e ekspertës së aktuaristikës e datës 20.12.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç e të gjitha ato së bashku dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase:

-Nga kontrata e punës e lidhur në mes të “MC Communication”, Sh.P.K., me nr.të biznesit 70571641, me seli në Prishtinë, si punëdhënëse dhe punëtorit-tani të ndjerit Dorian Shkodra, si punëmarrës, gjykata vërtetoi faktin se i ndjeri D. Sh. kishte lidhur kontratë pune me kohë të caktuar vetëm për tre muaj dhe atë prej datës 28.04.2011 e deri më datë 28.07.2011.

-Nga ekspertiza e ekspertës së aktuaristikës Gresa Shabani, e datës 20.12.2023, gjykata vërtetoi faktin se llogaritja e mbajtjes së munguar dhe rentës mujore për të ardhmen për prindërit e të ndjerit D. Sh., tani paditësit L. dhe N. Sh., për periudhën prej datës së aksidentit 12.09.2011 e deri më 28.09.2022, duke marrë për bazë të ardhurat neto të të ndjerit sipas kontratës së skaduar tek punëdhënësi dhe duke konsideruar supozimin se prindërit janë të pa punë dhe nuk realizojnë të ardhura mujore të cfarëdo forme përfshirë edhe ndihmë sociale dhe nën supozimin se i ndjeri ka mund të jetë mbajtës i vetëm i familjes, arrin në totalin prej 16,403.74 euro.

Baza ligjore:

Gjykata, në këtë çështje kontestimore ka aplikuar dispozitat e Ligjit për Familjen e Kosovës neni 294 paragrafi 1 në të cilin përcaktohet se: *“Fëmijët kanë për detyrim të japin mbajtje financiare për prindërit e tyre nëse ata nuk nuk janë të aftë për punë dhe nuk kanë të ardhura minimale për të jetuar”*, po ashtu gjykata është bazuar në nenin 319 të LPK-së në të cilin thuhet se: *“secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, kurse neni 322.1 ka paraparë *“në qoftëse gjykata në bazë të provave të marrura (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*, ndërsa neni 322.2 ka paraparë *“pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj po qe se ligji nuk parasheh diç tjetër”*.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës:

Gjykata, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia refuzuar kërkesëpadinë paditësve, sa i përket fitimit të humbur-rentës për të kaluarën dhe të ardhmen në formë të kapitalizuar si pasojë e aksidentit të datës 12.09.2011 në Gjilan, ku humbi jetën i ndjeri D. Sh.,

pasi gjeti se paditësve nuk iu takon kompensimi në formë të rentës për llogaritjen e mbajtjes së humbur, pasi që duke u bazuar në nenin 294 të LMF-së, paditësit janë të aftë për punë dhe të njëjtit kanë të ardhura minimale për jetëse, e kjo u vërtetua nga ajo se vet paditësja N. Sh. në seancën e datës 04.06.2014, ka deklaruar se bashkëshorti i saj, këtu paditësi L. Sh.a është në marrëdhënie pune në cilësi të vozitësit te firma “Kualiteti”, në Gjilan dhe është i vetmi mbajtës i familjes në aspektin material, po ashtu edhe nga certikatat e lindjes shihet se paditësit janë të moshës së re, pra nuk janë të moshës së shtyer ku e kishin pasur të vështirë sigurimin e ekzistencës së tyre e kjo duke u bazuar në certikatat e lindjes për paditësit N. dhe L. Shkodra ku u vërtetua se të njëjtit janë të viteve 1971-73, si dhe duke u bazuar në atë se i ndjeri D. Sh., gjegjësisht djali i tyre nuk ka pasur kontratë të rregullt të punës por vetëm kontratë tre mujore dhe atë nga data 28.04.2011 deri më 28.07.2011, si dhe i njëjti ka qenë nxënës i shkollës së mesme pra i njëjti nuk ka qenë mbajtësi i vetëm i familjes,

Deri te ky konstatim, gjykata erdhi duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë dhe dispozitat ligjore në fuqi, si dhe duke u bazuar në ekspertizën e ekspertës së aktuaristikës Gresa Shabani, e datës 20.12.2023, e cila konstatoi se llogaritja e mbajtjes së munguar dhe rentës mujore për të ardhmen për prindërit e të ndjerit D. Sh., tani paditësit L. dhe N. Sh., për periudhën prej datës së aksidentit 12.09.2011 e deri më 28.09.2022, duke marrë për bazë të ardhurat neto të të ndjerit sipas kontratës së skaduar tek punëdhënësi u bë duke konsideruar **supozimin** se prindërit janë të pa punë dhe nuk realizojnë të ardhura mujore të cfarëdo forme përfshirë edhe ndihmë sociale dhe nën supozimin se i ndjeri ka mund të jetë mbajtës i vetëm i familjes, mirëpo për gjykatën kjo nuk ishte kontestuese pasi që paditësi është në marrëdhënie pune në cilësi të vozitësit te firma “Kualiteti”, në Gjilan dhe është i vetmi mbajtës i familjes në aspektin material dhe se i ndjeri D. Sh., gjegjësisht djali i tyre nuk ka pasur kontratë të rregullt të punës por vetëm kontratë tre mujore dhe atë nga data 28.04.2011 deri më 28.07.2011, ku kontrata e punës i ka skaduar para ditës së shkaktimit të aksidenti me datë 12.09.2011, dhe i njëjti ka qenë nxënës i shkollës së mesme pra i njëjti nuk ka qenë mbajtësi i vetëm i familjes.

Po ashtu, gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit sa i përket mbulimit të shpenzimeve për ngritjen e përmendores në shumë prej 2,050.00 euro, pasi që bazuar në nenin 319 të LPK-së në të cilin thuhet se: *“secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, kurse neni 322.1 ka paraparë *“në qoftëse gjykata në bazë të provave të marrura (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*, ndërsa neni 322.2 ka paraparë *“pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj po qe se ligji nuk parasheh diç tjetër”*.

Duke qenë se paditësit nuk e provuan faktin qenësor për realizimin e kërkesës së tyre, pasi që paditësit me asnjë provë materiale nuk vërtetuan se të njëjtit kanë bërë shpenzime në ngritjen e përmendores-lapidarit, gjykata vlerësoi se të njëjtit kanë dështuar të vërtetojnë bazën e kërkesës së tyre.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta të procedurës, pasi e paditura pavarësisht suksesit në procedurë, nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, andaj bazuar në nenin 449, 452, paragrafi 1 e 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në pikën II të këtij aktgjykimi.

Nga të lartëcekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 par. 1 të LPK-së.

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1375/2021, më datë 16.01.2024

Gjyqtarja,
Florije Qerimi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.